



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 81

Tiranë – E premte, 28 maj 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 19.5.2021	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërive “SVILUPPO MARE 1” sh.p.k. dhe “S&D INVEST” sh.a., si blerës, për pasurinë shtetërore, e cila ndodhet në Hamallaj, Durrës, zona kadastrale 1925, e cila prek pasurinë nr. 20/6, me sipërfaqe 55 000 m ² 8533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 293, datë 19.5.2021	Për miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostimë (Egnatia - Shushicë), me nr. 4 rep. & nr. 1 kol., datë 20.2.2013” 8538
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 26.5.2021	Për miratimin e llojeve të armatimit të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit..... 8545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 26.5.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 18, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë” 8546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 26.5.2021	Për heqjen nga fondi pyjor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 2.874 ha, në objektin “Rubik”, të Bashkisë Mirditë, që do të përdoret nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të Bazaltit..... 8547
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 88, datë 10.5.2021	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2021–2022, në sistemin arsimor parauniversitar..... 8549
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 26.4.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar” 8549

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 26.4.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento SRL Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar”	8553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 26.4.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”	8558
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 26.4.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, për vitin 2020.....	8562
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 26.4.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.....	8563
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 26.4.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, për vitin 2020.....	8564
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 25/5, datë 26.5.2021	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Çorovodë”	8566



VENDIM
Nr. 292, datë 19.5.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PËR LIDHJEN E KONTRATËS PËR
KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË
PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË
PLANEVE TË PËRGJITHSHME
VENDORE, NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCave DHE EKONOMISË, SI
SHITËS, DHE SHOQËRIVE “SVILUPPO
MARE 1” SHPK DHE “S&D INVEST” SHA,
SI BLERËS, PËR PASURINË
SHTETËRORE, E CILA NDODHET
NË HAMALLAJ, DURRËS,
ZONA KADASTRALE 1925,
E CILA PREK PASURINË NR. 20/6,
ME SIPËRFAQE 55 000 m²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore (lejeve zhvillimore), ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërive “Sviluppo Mare 1” sh.p.k. dhe “S&D Invest” sh.a., si blerës, për pasurinë shtetërore, e cila ndodhet në Hamallaj, Durrës, zona kadastrale 1925, e cila prek pasurinë nr. 20/6, me sipërfaqe 55 000 m², sipas plan-rilevimit dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. _____ REP.
NR. _____ KOL.

KONTRATË SHITJEJE ME KUSHT
PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE
(TRUALL) NË PRONË PRIVATE NË FAVOR
TË SHOQËRIVE “SVILUPPO MARE 1”
SHPK DHE “S&D INVEST” SHA

Lidhur sot, më datë _____.____.2021, (dy mijë e njëzet e një), përpara meje noterit _____, me seli në Tiranë, u paraqitën personalisht dhe më kërkuan hartimin e kësaj Kontrate për kalimin e pronës shtetërore (truall) në pronë private, palët si më poshtë:

Neni 1
Palët

Pala shitëse: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë, përfaqësuar nga _____.

Pala blerëse: Shoqëria “Sviluppo Mare 1” sh.p.k., me NUIS L61706003C, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga e Dibrës, godinë me nr. pasurie 7/173, ZK 8360, kati i 2-të, e përfaqësuar nga _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. personal _____ dhe shoqëria “S&D Invest” sh.a., me NUIS K82112004C, me seli në Tiranë, Farkë, Rezidenca Kodra e Diellit, Selitë, e përfaqësuar nga _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. personal _____.



Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontratë shitjeje, me kushtet sipas përcaktimeve në nenin 4, është kalimi i pronës shtetërore (truall) në pronë private me sipërfaqe 55,000 m². Kjo pronë shtetërore ndodhet në Hamallaj, Durrës, Zona Kadastrale 1925 dhe prek pasurinë nr. 20/6.

Këto pasuri shtetërore kufizohen sipas hartës treguese bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 3

Çmimi i shitjes

3.1 Çmimi i shitjes së pasurisë shtetërore, që kalon në pronë private është 59,565,000 lekë. Kjo vlerë është paguar plotësisht nga pala blerëse për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike Tiranë, në llogarinë të “ardhura nga shitja-tokë, troje, terrene” me nr. 1161110, sipas kushteve të vendosura në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

3.2 Pala shitëse deklaron, se në favor të saj është derdhur e gjithë shuma e përcaktuar në pikën 3.1 të këtij neni, para kohës së përpilimit të kësaj kontrate, sipas mandataritetit nr. _____, datë _____.2021 në Bankën _____.

Neni 4

Kushtet e shitjes

4.1 Pala blerëse ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga pala shitëse në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

4.2 Blerësi gjykohet se ka njohuri të plota për pasurinë pronë shtetërore, e cila ndodhet në Hamallaj, Durrës, që kalon në pronë private dhe nuk ka asnjë pretendim lidhur me të.

4.3 Momenti i kalimit të pronësisë së pronës shtetërore, në pronë private do të lidhet me realizimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private.

4.4 Nëse miratimi i lejes për zhvillimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private, nuk bëhet brenda 5 (pesë) vjetëve nga nënshkrimi i kontratës, atëherë kontrata zgjidhet dhe palët i kthejnë njëra-

tjetrës çdo gjë që i kanë dhënë si pasojë e kësaj kontrate.

4.5 Çmimi i përfituar nga kalimi i sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas këtij vendimi, kalon 100 për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 5

Detyrimet e shitësit

5.1 Shitësi garanton se prona që kalon në pronë private është pasuri shtetërore, fakt të cilin e vërteton i gjithë dokumentacioni që është i depozituar në dosjen përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike.

Neni 6

Të drejta dhe detyrime të blerësit

6.1 Blerësi ka pranuar kalimin e pronës shtetërore në pronë private, sipas kushteve të përcaktuara në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2021.

6.2 Blerësit i kalon e drejta e pronësisë mbi pronën shtetërore, pas lidhjes së kësaj kontrate shitjeje dhe të regjistrimit të saj në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore Durrës, pasi të jetë plotësuar kushti, sipas nenit 4, pika 4.3.

6.3 Blerësi merr përsipër për të paguar të gjitha shpenzimet për veprimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë akt, bazuar në nenin 708 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Baza ligjore për lidhjen e kontratës

7.1 Neni 83, 705, i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 807, datë 11.12.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin



e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshëm vendore.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve për pikat e kësaj kontrate zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Pjesët përbërëse të kontratës

9.1 Pjesë e kësaj kontrate janë: autorizimi për kryerje pagese nr. ____ prot., datë _____.2021, lëshuar nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë; kartelat e pasurisë së paluajtshme me HTR për sipërfaqen që ka në pronësi dhe sipërfaqen pronë shtetërore që kalon në pronë private, plan-vendosja e sipërfaqes pronë shtetërore, mandatpagesa e cituar në nenin 3, pika 3.2 të kësaj kontrate, ekstrakti i Regjistrimit Tregtar.

Neni 10

Dispozita përfundimtare

10.1 Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje, me vlerë të njëjtë dhe përbëhet nga 3 (tri) faqe secila, ku një kopje qëndron pranë kësaj zyre noteriale, një kopje u jepet blerësve një kopje i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Durrës, një kopje i jepet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike.

10.2 Kontrata, pasi lexohet nga palët, kuptohet përmbajtja e saj, është e njëjtë me vullnetin e tyre dhe nënshkruhet pa vërejtje para noterit.

10.3 Për sa më sipër, unë noter, pasi konstatova se akti i mësipërm është në pajtim të plotë me vullnetin e palëve dhe me ligjin e vërtetoj atë rregullisht.

Neni 11

Regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

11.1 Regjistrimi i kësaj kontrate shitjeje në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore Durrës, do të bëhet nga blerësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj. Në të kundërt, për çdo ditë vonese, në bazë të ligjit nr. 111/2018, datë 7.2.2019, “Për kadastrën”, detyrohet të paguajë një tarifë shtesë gjobe konform rregullave përkatëse.

PALËT KONTRAKTUESE**PALA SHITËSE**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike



PALA BLERËSE


Shoqëria “Sviluppo Mare 1” sh.p.k.

Shoqëria “S&D Invest” sh.a.

NOTERI



PLAN RILEVIMI	
PERGATITI MARGARIT STAVRI a Nr. T1188/1 Date: 29.05.2017 : pergatitjes _____  MARGARIT STAVRI Ing. Gjeo. Inzh. (T1188/1) Licenca: Nr. T1188/1 Vula/Firma	 IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 1925 NR. I PASURISE 246 VOL. 124085 INDEKSI I HARTES K-34-88-(129-C) SHKALLA 1:2500 ADRESA E PASURISE: Rrethi DËRRËS Q/F N/B HAMALLAJ Rr/L _____ SIP = 55000 m ² LQI: TRUALL PRONARI_SHTET
NDARIA E PRONES NE DY SIPERFAQE SIPERFAQJA TOTALE E PRONES E CILA NDAHET ESHTHE PRONE SHITESH = 202200M ² SIPERFAQJA -1- = 55000 M ² SIPERFAQJA E NGJELUR = 147200 M ² TE NGJYRE JESHILE JANE PRONAT PRIVATE TE NGJYRE TE KUQE ESHTHE PRONA SHITESH E CILA KERKOHET PER PRIVATIZIM	
	





VENDIM

Nr. 293, datë 19.5.2021

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS
SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME NË KONTRATËN E
KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM),
PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN
GOSTIMË (EGNATIA - SHUSHICË),
ME NR. 4 REP. & NR. 1 KOL.,
DATË 20.2.2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31, pika 2, e 50, ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostimë (Egnatia - Shushicë), me nr. 4 rep. & nr. 1 kol., datë 20.2.2013”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 1284 Rep.
NR. 1284 Kol.



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN GOSTIMË
(EGNATIA-SHUSHICË), ME NR. 4 REP. & NR. 1 KOL., DATË 20.02.2013**

Në Tiranë, më datë 06, muaji May, viti 2021 (dymijë e njëzetënj), para meje noter G. G. G. G., anëtar vdhomës së Noterisë Tirane me adresë En' Gjergj. Fishta u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 8726 Prot, datë 14.12.2020 (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Bejtja, i datëlindjes 17.01.1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit me Nr. 033398299 dhe Nr. Personal G60117004R (në vazhdim referuar si “Autoriteti Kontraktues”);

dhe

Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me 29.01.2018, me seli qendrore në adresën: Rruga “Rrapo Hekali”, Pallati Bëm sh.p.k., Ap. Nr. 16, Tiranë, me NUIS L82529203M, me përfaqësues ligjor Z. Paqsor Buzi, shtetas shqiptar i lindur më 03.09.1970, në Lushnje, banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H00903078F (në vazhdim referuar si Shoqëria Koncesionare)

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit “Egnatia Shushicë”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vëllezërit-Tola” sh.p.k., “Arti” sh.p.k., dhe “G.P.A. Konstruksion” sh.p.k. me Nr. 4 Rep & Nr. 1 Kol, nënshkruar më datë 20.02.2013, dhe miratuar me VKM Nr. 258, datë 27.03.2013.



Hyrje



A2021053840037477966

Duke pasur parasysh se:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Vëllezërit Tola" sh.p.k., "Arti" sh.p.k. dhe "GPA Konstruktion", sh.p.k., është nënshkruar kontrata e koncesionit e llojit "BOT", për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Gostimë, me Nr. 4 Rep & Nr. 1 Kol, nënshkruar më datë 20.02.2013, dhe miratuar me VKM Nr. 258, datë 27.03.2013;
- Dhënia e këtij hidrocentrali ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, nga viti 2011 deri në vitin 2015. Në përfundim të gjykimit në të gjitha shkallët është lënë në fuqi Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili midis të tjerave ka vendosur në favor të ofertuesit, bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Vëllezërit Tola" sh.p.k., "Arti" sh.p.k. dhe "G.P.A Konstruktion" sh.p.k.;
- Me shkresën Nr. 4633/4 Prot. datë 23.10.2017 është miratuar krijimi i shoqërisë së projektit bazuar në nenin 8 të kontratës koncesionare "Egnatia Hydropower" sh.p.k.;
- Struktura e shoqërisë koncesionare "Egnatia Hydropower" sh.p.k. ka pësuar ndryshime, ku kuotat e shoqërive "Vëllezërit Tola" sh.p.k., "Arti" sh.p.k. dhe "G.P.A Konstruktion" sh.p.k., janë blerë 100% nga shoqëria "G.P.G. COMPANY" Sh.p.k. Transferimi i kuotave të 25% të kuotave të të shoqërive "Arti" sh.p.k. dhe "G.P.A Konstruktion" sh.p.k. është regjistruar në QKB në datë 25.05.2018, pas miratimit paraprak të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, të dhënë me shkresën nr. 6851/1, datë 23/04.2018;
- Transferimi i 75% të kuotave të shoqërisë "Vëllezërit Tola" sh.p.k. të "G.P.G. COMPANY" Sh.p.k. është regjistruar në QKB në datë 17.12.2019. Për këtë transferim është vlerësuar se nuk jemi para rastit të transferimit tek palët e treta, pasi shoqëria "Vëllezërit Tola" sh.p.k. zotërohet 100% nga shoqëria "G.P.G. COMPANY" Sh.p.k. Për më tepër shoqëritë kanë nënshkruar tashmë marrëveshjen për bashkimin e shoqërisë tregtare mëmë "G.P.G. COMPANY" Sh.p.k. me shoqërinë bijë "Vëllezërit Tola" sh.p.k., aktet e së cilës janë depozituar edhe në QKB;
- AKBN-ja, me shkresën e saj Nr. 508 prot. date 15.01.2019 "Dërgohet Raporti Oponencës Teknike mbi Projektin e Zbatimit të HEC-eve "Kaskada Egnatia-Shushicë, të shoqërisë koncesionare "Egnatia Hydropower" sh.p.k, protokolluar në MIE me Nr. 600 Prot. datë 15.01.2019 ka dërguar në MIE raportin e oponencës teknike mbi këtë projekt zbatimi, si dhe një kopje të vulosur të dokumentacionit të këtij projekt zbatimi. Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), me shkresën Nr. 600/2 Prot. datë 17.01.2019 "Miratohet projekti i zbatimit të hidrocentraleve "Kaskada Egnatia-Shushicë", referuar konkluzionit përfundimtar të Oponencës Teknike të AKBN, ka miratuar projektzbatimin, si dhe ndryshimi i parametrave është reflektuar në kontratën shtesë të nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë dhe përfaqësuesit të MIE-s (sipas autorizimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 14073, datë 16.11.2018).



- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k, me Nr. 42 Prot. datë 08.11.2019 “Kërkesë për ndryshim të skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të projektit të zbatimit hec-et Gostima 1-6”, protokolluar në MIE me Nr. 9654 Prot. datë 08.11.2019, ka dërguar në MIE projekt zbatimin e rishikuar për shfrytëzimin e kaskadës së lumin Gostima. AKBN-ja me Nr. 2490/2 Prot. datë 22.06.2020 “Dërgohet raporti e opionencës teknike mbi projektin e zbatimit të Hec-eve “Kaskada Egnatia Shushicë, të shoqërisë koncesionare “Egnatia Hydropower” sh.p.k, protokolluar në MIE me Nr. 4109/1 Prot. datë 22.06.2020, ka dërguar në MIE raportin e opionencës teknike mbi këtë projekt zbatimi të rishikuar, si dhe një kopje të vulosur të dokumentacionit të këtij projekt zbatimi. Ky raport është miratuar nga MIE me shkresën Nr. 4109/6 Prot. datë 14.12.2020 “Miratohet projekti i ndryshuar i zbatimit të hidrocentraleve mbi lumin Gostimë”;
- Për të adresuar rekomandimet e projektit të zbatimit, është nevoja që në kontratën koncesionare të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjetike të hidrocentraleve “Kaskada Egnatia-Shushicë”, në përputhje me projektin e zbatimit;
- Në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 19074/4 Prot. datë 07.12.2020 është shprehur dakord paraprakisht në lidhje me propozimin e ndryshimit të kontratës;
- Me anë të shkresës me Nr. 20 Prot. datë 20.01.2020, protokolluar në MIE me Nr. 884 Prot. datë 20.01.2021 shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k, ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Formularin e Sigurimit të Kontratës sipas vlerës së investimit të Projekt-zbatimit të miratuar dhe kopje të preventivave, në përputhje me projekt-zbatimin e miratuar nga AK. Shoqëria ka propozuar që për shkak të vonësave të shkaktuara në miratimin e projektit të zbatimit, në kontratën e amenduar të shtyhen edhe afatet për pagisje me leje;
- Në zbatim të nenit 30 “Ndryshime”, të Kontratës së Koncesionit përcaktohet se kontrata me pëlqim të të dy palëve, mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime, që pasi të hyjnë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate”;

Duke marrë parasysh sa më sipër, Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqëria Koncesionare e projektit “Egnatia Hydropower” sh.p.k, bien dakord që në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “Egnatia Shushicë”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vëllezërit Tola” sh.p.k, “Arti” sh.p.k. dhe “G.P.A Konstruktion” sh.p.k, me Nr.4 Rep &Nr. Kol, datë 20.02.2013, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Kudo, togfjalëshi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të zëvendësohet me togfjalëshin “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”.



Neni 2

Në pikën 3 “Karakteristikat e Hidrocentralit” të Kontratës së Koncesionit, pikat 3.1 dhe 3.2 ndryshohen si më poshtë:

“Pika 3.1 Hidrocentralet mbi lumin Gostimë do të ndërtohen në rrethet e lumin Gostime, përfshirë dhe deget e tij, rrethi Elbasan - Librazhd, me kapacitetin e ndërtimit të përgjithshme:



- Fuqia e Instaluar 48 864 kW
- Prodhimi i Energjisë Elektrike 150, 914, 174 kWh/vit.
- Të zbatohet projektin për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostime, rrethi Elbasan-Librazhd me fuqi totale jo më pak se 48, 864 kW.

Projekti i zbatimit, ka këto parametra hidroenergjitikë

Hidrocentrali “Gostima 1”

- | | |
|---|------------------|
| - Kuota e veprës së marrjes 1/1 | 1300 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 1/2 | 1300 m.m.n.d. |
| - Kuota e godinës së centralit | 960 m.m.n.d. |
| - Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh | 10, 897, 499 kWh |
| - Fuqia totale e instaluar kW | 3047 kW |

Hidrocentrali “Gostima 2”

- | | |
|---|------------------|
| - Kuota e veprës së marrjes 1 (lumi Gostime) | 958 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 2 (përroi baresit) | 972 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 3 (përroi Valcit) | 970 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 4 (përroi Sopotit) | 960 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 5 (përroi Dekë e Madhe) | 915 m.m.nd |
| - Kuota e godinës së centralit | 705 m.m.n.d. |
| - Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh | 16, 822, 445 kWh |
| - Fuqia totale e instaluar kW | 5586 kW |

Hidrocentrali “Gostima 3”

- | | |
|--|------------------|
| - Kuota e veprës së marrjes 1 (lumi Gostime) | 705 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 2 (gura e Krashnës) | 1050 m.m.n.d. |
| - Kuota e veprës së marrjes 3 (përroi i Vilanit) | 790 m.m.n.d. |
| - Kuota e godinës së centralit | 560 m.m.n.d. |
| - Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh | 23, 400, 170 kWh |
| - Fuqia totale e instaluar kW | 5335 kW |

**Hidrocentrali “Gostima 4”**

- Kuota e veprës së marrjes
- Kuota e godinës së centralit
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh
- Fuqia totale e instaluar kW

558 m.m.n.d.
452 m.m.n.d.
A2021053840037477966
24, 475, 410 kWh
7396 kW

Hidrocentrali “Gostima 5”

- Kuota e veprës së marrjes 1 (lumi Gostime) 450 m.m.n.d.
- Kuota e veprës së marrjes 2 (përroi Qershizës) 453 m.m.n.d.
- Kuota e veprës së marrjes 3 (përroi Shamrit) 453 m.m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 315 m.m.n.d.
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh 28, 362, 642 kWh
- Fuqia totale e instaluar kW 10321 kW

Hidrocentrali “Gostima 5/1”

- Ska veprë marrje dhe shfrytëzon ujin që del nga kanali ujitës i Gostimës
- Kuota e godinës së centralit 386 m.m.n.d.
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh 1, 487, 504 kWh
- Fuqia totale e instaluar kW 450 kW

Hidrocentrali “Gostima 6”

- Kuota e veprës së marrjes 311 m.m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 130 m.m.n.d.
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh 45, 648, 504 kWh
- Fuqia totale e instaluar kW 16 819 kW

Pika 3.2 Hidrocentralet do të ndërtohen nga kuota 1300 m mbi nivelin e detit ku ndodhet vepra e marrjes 1/1 te hec-it të sipërm (Gostima 1), deri në kuotën 130 m mbi nivelin e detit ku është kuota e godinës së centralit ë hec-it të poshtëm (Gostima 6).”

Neni 3

Në pikën 5 “Të drejtat e Koncesionit” të Kontratës së Koncesionit, pika 5.2.1 (c) dhe 5.3 (a), ndryshohen si më poshtë:

“Pika 5.2.1 (c) Sipas percaktimeve te nenit 5.3 aksesin ne/dhe perdorimin e ujit te lugines se lumit gostime ndermjet 1300 metra mbi nivelin e detit dhe 130 metra mbi nivelin e detit, perfshire lumin Gostime, deget dhe burimet e tij, brenda kfijsve gjeografik te percaktuar ne aneksin I.



Pika 5.3 (a) “Disponimi i shesheve, e Drejta e Kalimit, Gezimi i Qete dhe e drejta per aksesin dhe perdorimin e ujit te lugines se lumit Gostimë, ndermjet 1300 metra mbi nivelin e detit dhe 130 metra mbi nivelin e detit, perfshire lumin Gostimë me te gjitha degët dhe burimet e tij, i jepet Koncesionarit pasi ky i fundit i jepet Kontraktues kopje të policave të sigurimit të cialt vërtetojnë se Koncesionari është siguruar për riskun sipas dispozitave të kësaj kontrate në përputhje me Ligjin dhe në përputhje me nenet 265 dhe 277 të Kodit Civil.

Neni 4

Në pikën 13 “Mirësimi i Investimeve” të Kontratës së Koncesionit, pika 13.1 dhe 13.3 ndryshohen si më poshtë:

“**Pika 13.1** Mbi bazën e të dhënave të projektit te rishikuar te zbatimit, miratuar nga Autoriteti Kontraktues me shkresen Nr. 4109/6 Prot. datë 14.12.2020 “*Miratohet projekti i ndryshuar i zbatimit të hidrocentraleve mbi lumin Gostimë*”, investimet duke përfshirë edhe kostot e financimit që duhet të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale 7, 541, 571, 915 (shtatë miliard e pesëqind e dyzet e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) Lekë me TVSH, nga te cilat vlera prej 1 591 377 333 (një miliard e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, është vlera e investimit për makineri dhe pajisje.

Pika 13.3 Vlera e ndryshuar e investimit do të jetë 7, 541, 571, 915 (shtatë miliard e pesëqind e dyzet e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë një mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) Lekë me TVSH, por jo më e vogël se 7 164 493 319 (shtatë miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë), e cila përfaqson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total.”

Neni 5

Në pikën 14 “Programi i Punimeve” të Kontratës së Koncesionit, pika 14.1.1 dhe 14.1.2 ndryshohen si më poshtë:

“**Pika 14.1.1** Koncesionari merr persiper te filloje punimet per zbatimin e projektit te ndertimit sipas percaktimeve te Aneksit K, brenda 2 muajve nga data e zbardhjes se lejes se ndertimit. Aplikimi per pajisjen me leje ndertimi, do te kryhet ne perputhje me rregullat e percaktuara ne Aneksin B.

Pika 14.1.2 Koncesionari merr persiper te vere ne pune hidrocentralet brenda 40 muajve nga data e fillimit te punimeve. Afati per pajisjen me lejet e nevojshme eshte 24 muaj nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate shtese koncesioni.”

Neni 6

Në pikën 19, Sigurimi Kontratës së Koncesionit shprehja “Një shume prej lekë 390, 302, 901, 3 që përbën 5% të vlerës totale të investimit” zëvendësohet me “Një shume prej lekë 316,903,250 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tre mijë e duqind e pesëdhjetë lekë) që përbën 5% të vlerës totale të investimit”.



Neni 7

Pika 25.3.1 e kontratës së koncesionit ndryshohet si vijon:



A202105384003747966

“25.3.1 Në rast mosrealizimi për faj të koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 150, 914, 174 kwh/vit, Koncesionari penalizohet me 3% të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese. Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkaqe të tjera të ligjshme (ku përfshihet, por nuk kufizohet çdo rrethanë objektive që ndikon në uljen e sasisë së prurjeve të ujit), Koncesionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar. Ndërkaq Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën koncesionare në vlerën 3.5% të prodhimit të realizuar.”

Neni 8

Ky shtese kontrate koncesioni nënshkruhet nga palët, është pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit dhe hyn në fuqi me miratimin e saj nga ana e Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Aneksi G (Kaskada e hidrocentraleve mbi pellgun e lumit Gostime dhe degët e tij), **Aneksi I** (Baseni Ujëmbledhës i Lumit Shkumbin, pellgu i lumit të Gostimes), **Aneksi K** (Grafiku i punimeve), **Aneksi L** (Emri i hidrocentraleve) të kontratës së koncesionit, ndryshohen sipas ndryshimeve të projektit të rishikuar të zbatimit, të miratuar nga Autoriteti Kontraktues me shkresën Nr. 4109/6 Prot. datë 14.12.2020 “Miratohet projekti i ndryshuar i zbatimit të hidrocentraleve mbi lumin Gostimë”, dhe i bashkelidhen kesaj kontrate.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Përfaqësuar me Autorizim Nr. 8726 Prot.
datë 14.12.2020 të Ministrit të Infrastrukturës
dhe Energjisë

KONCENSIONARI

Shoqëria “Egnatia
Hydropower” Sh.p.k

Z. Ilir Bejtja

Ilir Bejtja
ZEVENDESMINISTER

Z. Paqsor Buzi



ADMINISTRATOR

*Notere
Gentjana*

[Signature]
Fq. 1





VENDIM
Nr. 303, datë 26.5.2021

PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË
ARMATIMIT TË LËNDËVE
NEUROPARALIZUESE DHE TË
MJETEVE TË TJERA TË PËRDORIMIT
TË FORCËS NGA POLICIA E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 99, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Deri në rinovimin e plotë të armatimit, strukturat e Policisë së Shtetit të pajisen me armatimin dhe pajisjet aktuale.

3. Vendimi nr. 293, datë 8.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

LLOJET E ARMATIMIT TË LËNDËVE
NEUROPARALIZUESE DHE TË MJETEVE
TË TJERA TË PËRDORIMIT TË FORCËS
NGA POLICIA E SHTETIT

Punonjësit dhe strukturat e Policisë së Shtetit pajisen me armatim, municion dhe pajisje mbrojtëse e të përdorimit të forcës për kryerjen e detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik të çdo punonjësi policie, sipas kësaj lidhjeje.

Strukturat e Policisë së Shtetit pajisjen me armë, municion dhe pajisje speciale, në përputhje me ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.

Llojet e armatimit, municioneve dhe pajisjeve janë, si më poshtë:

1. Armatim

1.1 Armë zjarri për përdorim individual:

a) armë të shkurtra zjarri (pistoletë) kalibër 9x19 mm.

1.2 Armë zjarri në administrim në bazë njësie:

a) armë të gjata zjarri gjysmautematike kalibër 5.56x45 mm deri 9x19 mm;

b) armë të gjata zjarri automatike kalibër 5.56 x 45 mm deri 9x19 mm.

1.3 Armë speciale:

a) armë e gjatë zjarri me përpikëri të lartë gjysmëautomatike kalibër 5.56x45 mm deri 12.7x 99 mm;

b) armë me elektroshok;

c) armë për përdorim/hedhje të municioneve dhe mjeteve të ndryshme (shotgun/lëshues);

ç) armë të drejtuara me energji (ADE);

d) armë për alarm dhe sinjalizim;

dh) armë pneumatike;

e) armë për sinjalizim të lehtë akustik;

ë) armët me harkose me tojë;

f) armë zjarri me zhurmëzbutës të montuar;

g) armë zjarri të kombinuara;

gj) armë e ftohtë;

h) armë zjarri sportive;

i) armë ceremoniale;

j) mjete optike të armëve të zjarrit për shikim dhe shënjim;

k) pjesë kryesore të armëve të zjarrit;

l) pajisje e posaçme për armët e zjarrit;

ll) armë të tjera për përdorim policor, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë.

2. Municion:

a) municione për armët e shkurtra e të gjata të zjarrit sipas kalibrave përkatës, me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit;

b) municione që hidhen me shotgun me saçme: gome, metalike, sintetike;

c) municione me lëndë kimike (irrituese/ngacmuese) në formë pluhuri ose lëngu për përdorim policor, që hidhen me shotgun/lëshues, me granatë dore, pajisje hedhëse, spraj (individual/kolektiv) ose tubet, për mbrojtje, menaxhimin dhe kontrollin e turmave, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve



a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese:

i. fishekë me gas lotsjellës që hidhen me shotgun;

ii. granata me gas lotsjellës që hidhen me dorë;

iii. granata me gas lotsjellës që hidhen me lëshues;

iv. spraj individual me gas lotsjellës;

v. spraj kolektiv me gas lotsjellës;

vi. pajisje gashedhëse;

ç) granata akustike, tymuese dhe verbuese për përdorim policor, të cilat nuk sjellin dëme të pakthyeshme të shëndetit dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

d) lëndë plasëse për operacione policore.

3. Pajisje mbrojtëse e të përdorimit të forcës

3.1 Pajisje mbrojtëse e të përdorimit të forcës për përdorim individual:

a) jelek antiplumb i lehtë;

b) këmbisha jelekë balistik;

c) jelek antiplumb niveli III, IIIA, IV;

ç) kaska antiplumb me dhe pa pajisje komunikimi;

d) kaska balistike antiplumb;

dh) kaska plastike;

e) kostum për mbrojtje nga mjetet e forta;

ë) veshje antieksplziv;

f) mburoja balistike individuale;

g) mburoja plastike për mjetet e forta;

gj) mjete mbrojtëse nga lëndët kimike e bakteriologjike;

h) mjete mbrojtëse gjatë qitjes (syze balistike, kufje mbrojtëse për qitje);

i) pajisje dhe mjete optike individuale;

j) pajisje dhe mjete komunikimi;

k) pajisje dhe mjete ndriçuese;

l) pajisje dhe mjete orientimi (GPS, busulla);

ll) shkop gome/metalik;

m) pranga metalike;

n) pranga plastike;

nj) bilbil policie;

o) zinxhir individual.

3.2 Pajisje mbrojtëse e të përdorimit të forcës për përdorim kolektiv:

a) mburoja balistike kolektive;

b) pajisje dhe mjete optike (pajisje për shikim mbrapa pengesave; kamera termale, sondë, infra të kuqe; dylbi dite dhe nate);

c) detektor kërkimi (metal, eksploziv, lëndë radioaktive/kimike);

ç) pajisje vëzhgimi dhe zbulimi (dite dhe nate);

d) pajisje dhe aparate për përcaktimin e pozicionit gjeografik, distancave dhe objektivave;

dh) pajisje dhe mjete për operacione në lartësi (shkallë portative operacionale; pajisje alpinistike kolektive);

e) pajisje dhe mjete për depërtim në objekt (hapës hidraulik, shpërthyes dyersh, pinca universale, prerës hidraulik);

ë) pajisje dhe mjete kufizuese (barriera metalike, bllokues rrugësh, zinxhir kolektiv);

f) pajisje komunikimi në distancë;

g) sisteme dron/antidron;

gj) robotë antieksplzivë dhe të ndryshëm;

h) simulatorë trajnimi dhe aftësimi për çdo armë zjarri;

i) pajisje kontrolluese e testuese të qitjes;

j) pajisje të tjera për përdorim policor, të cilat do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj në Republikën e Shqipërisë.

VENDIM

Nr. 304, datë 26.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 18, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2021, PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Pika 1 e vendimit nr. 18, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi total prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, i cili detajohet, si më poshtë vijon:



a) 96 000 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë) lekë në zërin “shpenzime korrente”;

b) 4 000 000 (katër milionë) lekë në zërin “shpenzime kapitale”;

për financimin e hartimit e të botimit të 3 (tri) veprave madhore albanologjike dhe enciklopedike, përkatësisht:

- i. Enciklopedia shqiptare;
- ii. Fjalori i madh i shqipes;
- iii. Historia e shqiptarëve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 310, datë 26.5.2021

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 2.874 HA,
NË OBJEKTIN “RUBIK”, TË BASHKISË
MIRDITË, QË DO TË PËRDORET NGA
SHOQËRIA “VUTHAJ” SHPK,
PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT
TË BAZALTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 2.874 (dy pikë tetëqind e shtatëdhjetë e katër) ha, që do të përdoret nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të bazaltit në objektin “Rubik”, Bashkia Mirditë, të hiqet nga fondi pyjor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1 me të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum e hiqen nga fondi pyjor publik, si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt i

shfrytëzimit mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore, në sipërfaqen objekt shfrytëzimi, paguhet nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Mirditë, bazuar në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Vuthaj” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 7.652 (shtatë pikë gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Mirditë.

4. Bashkia Mirditë dhe shoqëria “Vuthaj” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara për pyllëzimin, dërgohen në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për bazalt”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore nga shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor publik të Bashkisë Mirditë.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mirditë, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë dhe shoqëria “Vuthaj” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe




Bashkia MIRDITË

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR PUBLIK QË
HIQEN PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHOQËRISË "VUTHAJ" shpk

Nr.	ID pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra/n/ngastra	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/kullosor ha	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	6
1	LE19 00 008d	Kulme-Derven-Fang	8d	0.485	bimësi pyjore
2	LE19 00 010a	Kulme-Derven-Fang	10a	1.957	trungishte
3	LE19 00 010b	Kulme-Derven-Fang	10b	0.432	trungishte
GJITHSEJ				2.874	

HARTA TOPOGRAFIKE
EKONOMISE PYJORE "KULME DERVENIT-FANG"

SHKALLA 1 : 25 000



Kordinatata e objektit (Gauss Krüge)	
Nr.	X
1	4399200 4625675
2	4399370 4625725
3	4399420 4625605
4	4399230 4625505

S=0.029Km²

SHOQERIA "VUTHAJ" sh.p.k.			STUDIMI TEKNIKO - EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT
ING Gjeodet: Gerard Lleshi	Sip. ngastra 10/a = 5165.744m ² Sip. ngastra 10/b = 19578.236m ² Sip. ngastra 8/d = 4325.719m ²		Nr prones: 392 / 5 Nr ngastres: 8 / d, 10/a, 10/b Sipërfaqe: 2.9 Ha
SHKALLA 1: 25 000	DATA	Viz. Nr. 1	OBJEKTI I BAZALTEVE "RUBIK", QARKU LEZHE ZONA MINERARE KONKURUESE Nr. 392/5



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 88, datë 10.5.2021

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
VITIT SHKOLLOR 2021–2022,
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2021–2022 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

a) mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 8 qershor 2022;

b) pushimet fillojnë 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

c) provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 9–30 qershor 2022.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

a) mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 15 qershor 2022;

b) për maturat, mësimet fillojnë më 13 shtator 2021 dhe mbarojnë më 1 qershor 2022;

c) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

ç) provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2–30 qershor 2022.

3. Në arsimin profesional:

a) mësimet fillojnë më 13 shtator 2021;

b) nxënësit e klasave të 10-ta, për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta, për strukturën 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 4-vjeçare, përfundojnë mësimet më 15 qershor 2022;

c) nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 2+1+1, dhe nxënësit e klasave të 11-ta, për strukturën 2+2, përfundojnë mësimet më 1 qershor 2022;

ç) për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 20 maj 2022;

d) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

dh) provimet përfundimtare, për kualifikimet profesionale të nivelit II dhe III të KSHK-së, zhvillohen në periudhën 1–15 qershor 2022;

e) provimet përfundimtare të praktikës profesionale, të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së, zhvillohen në periudhën 26 maj–1 qershor 2022;

f) provimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 2–30 qershor 2022.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 110, datë 26.4.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK,
PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË
BORDIT TË ERE-s NR. 35, DATË 4.2.2021,
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
‘BIOPOWER GREEN ENERGY’ SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008, TË
NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e



energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017 dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 58/3 prot., datë 23.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 6.4.2021, vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

- Ky vendim i Bordit është marrë me qëllim që t’i jepet mundësia shoqërisë për të depozituar në ERE dokumentacionin vërtetues mbi sa deklarohet nga ana e saj në kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 35/2021, si dhe për sqarime të mëtejshme apo dokumente shtesë, në lidhje me kërkesën e parashtruar. Shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit me shkresën e ERE-s nr. 51/7 prot., datë 9.4.2021.

- Në përmbushje të afatit të vendosur në vendimin sipërcituar, u vlerësua rishqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria, në kuadër të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021, me anë të të cilit filloi procedura për heqjen e licencës së shoqërisë, si dhe në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90/2008, të ndryshuar.

Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka depozituar në ERE vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021, “Për miratimin e statusit investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë” për projektin e investimit “parku me erë”, me subjekt aplikues “Biopower Green Energy” sh.p.k., me NIPT/NUIS K72405024M dhe “Marseglia Group” SRL CF00695260604. Me anë të këtij vendimi është miratuar statusi investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë për projektin e investimit “parku me erë”, që parashikon ndërtimin e dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2. Po ashtu, shoqëria pretendon se marrja e statusit të nënshkruar dhe nga Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në të vërtetë kapërcen problemet e ngritura në letren e regjistruar në ERE me nr. 714/1 prot., datë 13.7.2021, nga vetë MIE, dhe e vendos projektin në një pozicion tjetër krahasuar me projektet e tjera të erës.

- ERE, me vendimin nr. 35/2021, filloi procedurat për heqjen e licencës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., në rrethanat kur kjo e fundit nuk kishte plotësuar tërësisht të gjitha kushtet e vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, nuk kishte dërguar informacion apo dokumentacion në ERE në lidhje me përfundimet e grupit të punës, sa i përket dhënies së statusit të investimit strategjik e po ashtu MIE ishte shprehur kundër shtyrjes së afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike. ERE i është drejtuar gjithmonë ministrisë në lidhje me qëndrimin e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimeve për ndërtimin e parqeve eolike, për arsye se kjo ministri ka në fushën e përgjegjësisë së saj zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve energjetike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 504, datë 13.9.2017, e po ashtu, në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre. Duke qenë se bashkëpunimi me MIE-n për këto çështje është kërkesë e ligjit, ERE, për këtë qëllim ka vijuar edhe me dërgimin për mendim në MIE, sa herë këto çështje kanë qenë objekt rivlerësimi, sipas afateve të përcaktuara në vendimet respektive. Nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria konstatohet se anëtar i Komitetit të Investimeve Strategjike, që kryesohet nga Kryeministri, është dhe ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili ka nënshkruar dhe vendimin për dhënien e statusit investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë, duke dhënë në këtë mënyrë dakordësinë për zhvillimin e këtij projekti.

- Me dhënien e statusit investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë, për projektin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., vlerësohet se kanë ndryshuar rrethanat për të cilat u mor vendimi i bordit nr. 35/2021.



- Në përputhje me ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike”, në vendimin e Komitetit të investimeve strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021, përcaktohet se “Parku me erë” do të realizohet nga subjekti “Biopower Green Energy” sh.p.k. dhe “Marseglia Group” SRL. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të energjetikës dhe ndërtimin e dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 mw, përkatësisht parku i parë afërt portit të Shëngjinit 114 mw dhe parku i dytë, në bregdet, 120 mw. Statusi investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë i jepet këtij projekti për një periudhë 2-vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen fillimisht me vendim të Këshillit Bashkiak e më pas miratohen me VKM, në përputhje me VKM-në nr. 1030, datë 16.12.2015. Po ashtu në vendim janë përcaktuar dhe masat mbështetëse që i jepen projektit, ku përfshihet kryerja e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përsheptuara, si dhe asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, Në këtë vendim përcaktohen gjithashtu, organet përkatëse, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës etj., të cilat ngarkohen për të bërë propozimet përkatëse në Këshillin e Ministrave, për të vënë në zbatim dhe masat mbështetëse që përfiton investitori me marrjen e këtij statusi. Bashkëlidhur këtij vendimi është dhe plani i veprimit, ku përfshihen mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse.

- Për sa i përket faktit që shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE përpara marrjes së statusit të sipërcituar, sqarojmë se në nenin 34, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike”, i ndryshuar, është parashikuar se dispozitat e këtij ligji do të zbatohen gjithashtu, edhe për ato investime strategjike, për të cilat është nënshkruar një kontratë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që klasifikohen investime strategjike, në kuptim të këtij ligji, me qëllim realizimin dhe konkretizimin e tyre.

- Sa më sipër përcaktuar, vlerësohet se ndodhemi në rrethanat kur shoqëria ka aplikuar për

statusin, duke qenë e licencuar nga ERE, aq më tepër që ajo nuk e ka renditur procedurën e marrjes së licencës të masat mbështetëse që ka kërkuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) gjatë aplikimit për marrjen e statusit të investimit strategjik, pikërisht për arsye se kishte një licencë të vlefshme.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 51/6 prot., datë 30.3.2021 dhe nr. 51/7 prot., datë 21.4.2021, shoqëria ka bërë përditësim të informacionit mbi aktivitetin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për ndërtimin e dy parqeve me erë, BPGE1 & BPGE2, duke u shprehur se së bashku me AIDA-n, po ndjek dhe po zbaton planin e veprimit dhe zhvillimit të investimit e po ndërmerr të gjithë hapat për marrjen e autorizimeve të autoriteteve përgjegjëse. Për këtë shoqëria ka depozituar bashkëlidhur dhe shkresat që AIDA i ka drejtuar Bashkisë Lezhë në përdorim, konform planit të vendimit të KIS-së, shkresën e AIDA-s drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me masën mbështetëse të lejimit të përdorimit të pasurisë shtetërore, si dhe miratimin e saj paraparak për efekt të marrjes së lejes zhvillimore dhe lejes mjedisore etj.

- Rezulton se shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, germa “a”, të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, me përcjelljen në ERE të studimit të fizibilitetit, si dhe kushtin e vendosur në pikën 1, germa “d”, të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, që ka të bëjë me paraqitjen e opionencës tekniko-ekonomike nga ekspertë të licencuar. Si të tilla këto kushte duhen shfuqizuar.

- Nga sa analizuar, nga kushtet e vendimit nr. 90/2008, i ndryshuar, mbetet ende pa u depozituar marrëveshja e nënshkruar me OST sh.a. (pika 1, germa “b”), si dhe fakti që shoqëria nuk ka arritur të realizojë projektin brenda afateve të shtyra nga ERE (pika 1, germa “e”), arsye për të cilën ka kërkuar dhe shtyrjen e mëtejshme, nisur së fundmi dhe nga marrja e statusit investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë.

- Për gjithë sa më sipër, referuar përpjekjeve të shoqërisë dhe thujse ezaurimit të kushteve respektive të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, si dhe marrjes së fundmi të statusit investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë, u vlerësua pranimi i kërkesës së shoqërisë për rishikimin e



vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35/2021, me anën e të cilit filloi dhe procedura për heqjen e licencës së saj, duke e shfuqizuar atë.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

Duke marrë në konsideratë faktin se nga periudha e licencimit ka kaluar një kohë e gjatë e projekti nuk është vënë në zbatim, e mund të kenë ndryshuar dhe kushtet mjedisore, rikujtojmë se për qëllime të licencimit shoqëria ka depozituar lejen e mjedisit, me nr. 300 prot., datë 1.4.2008, dhënë me vendimin nr. 4, të Komisionit të Lejeve, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje. Gjithashtu, në kushtet e lejes është përcaktuar se mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe 2-vjeçare sjell për pasojë pavlefshmërinë e lejes për ushtrimin e këtij aktiviteti. Në këto rrethana, në kuadër dhe të vlerësimit të përpjekjeve të saj për realizimin e projektit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë, brenda 3 muajsh, në ERE lejen mjedisore të rinovuar.

Pas depozitimit të lejes së mjedisit të rinovuar dhe studimit të fizibilitetit, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, konkretisht sipas pikës 1, germa “b”, që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., dhe sipas pikës 1, germa “e”, që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektut, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

Pas depozitimit të lejes së mjedisit të rinovuar, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar, konkretisht sipas pikës 1, germa “b”, që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., dhe sipas pikës 1, germa “e”, që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektut, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

3. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, gerrat “a” dhe “d” të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, shfuqizohen.

2. Në pikën 1 të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, pas germës “f”, shtohet germa “g”, me këtë përmbajtje:

g) Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e mjedisit të rinovuar, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi.

4. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacion ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi.

5. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. të përditësojë në mënyrë periodike ERE-n mbi statusin e realizimit të planit të veprimit, në zbatim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 11/6, datë 4.2.2021.

6. Me dorëzimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, ERE do të shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 1, germa “b”, dhe pikën 1, germa “e”, të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

7. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

8. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Biopower Green Energy” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 111, datë 26.4.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO SRL ALBANIA’ SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017 dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 58/4 prot., datë 23.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 76, datë 19.3.2021, vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021.

- Ky vendim i Bordit u mor me qëllim që të saktësohej e të përcillej sipas formës ligjore dokumentacioni i depozituar së fundmi nga shoqëria, për të pasur kohën e nevojshme për të shqyrtuar këtë dokumentacion, si dhe me qëllim që t'i jepej mundësia shoqërisë të depozitonte në ERE dokumentacionin përkatës, për sa pretendohet nga ajo, në kuadër të kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 32/2021. Shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit me shkresën e ERE-s nr. 501 prot., datë 31.3.2021.

- Në përmbushje të afatit të vendosur në vendimin e sipërcituar, u vlerësua rishqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria, në kuadër të kërkesës së

saj për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, me anë të të cilit filloi procedura për heqjen e licencës së shoqërisë, e po ashtu në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.

- Shoqëria pretendon se, me gjithë problemet e hasura me sheshin e ndërtimit, për arsye se komunat Livadhja, Lukovë dhe Markat, të rrethit Sarandë, kanë ndërhyrë me vonesë për lirim të tij, si dhe problemet në lidhje me konfirmimin e plan-vendosjeve të pronave, në këto momente janë zgjidhur në mënyrë përfundimtare dhe ka filluar procedura e blerjes së tokës në të cilën do të vendosen turbinat.

Këto pretendime shoqëria i ka ngritur dhe më herët në ERE, por gjithsesi ato mbeten në kuadrin e deklaratave nga ana e shoqërisë. Duke qenë se ajo ka deklaruar se tashmë është zgjidhur çështja e pronësisë, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE sa pretendohet, si dhe korrespondencat përkatëse me bashkitë, dokumentacionin pronësor etj.

- Shoqëria pretendon se hapja e rrugëve për vendosjen e aparaturave matëse ka qenë një ndër arsyet për vonesën në fillimin e punës, duke specifikuar se janë përmirësuar rrugë ekzistuese dhe janë hapur rrugë të reja. Gjithashtu shoqëria thekson se ka depozituar në ERE projektet, kontratën dhe pagesat për rrugët kryesore e lidhëse.

Për sa pretendohet nga shoqëria, siç kemi theksuar dhe më parë, por edhe nga monitorimi i kryer, ka rezultuar se përveç mirëmbajtjes së rrugës me materiale inerte, të cilat grupi i punës i ka dokumentuar me foto nga terreni, nuk rezulton të ketë investim në zonën ku parashikohet të realizohet projekti. Përveç sa më sipër, nga monitorimi në terren rezultojnë ende të porealizuara investimet në rrugë, për shkak të pamundësisë financiare të shoqërisë, e cila ka vështirësi në pagesat e punonjësve dhe detyrimet e tjera kontraktore. Shpenzimet e pretenduara nga shoqëria nuk janë dokumentuar me dokumentacionin përkatës vërtetues.

Për gjithë sa më sipër, vlerësojmë se në çdo rast duhet të merren në konsideratë dhe vështirësitë me të cilat përballet realizimi i një projekti të tillë.

- Shoqëria pretendon se procedurat doganore kanë marrë kohën e tyre dhe në këtë moment është zgjidhur në mënyrë përfundimtare zhdoganimi i aparaturave për testimin e shpejtësisë së erës e, po ashtu, është detyruar të ngarkohet me kosto shtesë



për anemometrën e dëmtuar në vitin 2010, në komunën Lukovë.

Ky është një pretendim i ngritur dhe më herët nga ana e shoqërisë, në lidhje me shpenzimet shtesë që i është dashur të kryejë, për shkak të dëmtimit të anemometrit, edhe pse nuk është depozituar dokumentacion vërtetues për këtë shpenzim.

- Shoqëria pretendon se kriza financiare evropiane dhe ndërkombëtare ka tronditur investitorët dhe i ka bërë më hezitues për të marrë një vendim për të filluar këtë investim të rëndësishëm jo vetëm për vetë investitorët, por edhe për komunitetin e kësaj zone dhe më gjerë.

Megjithatë ka disa vite që shoqëria është licencuar nga ERE për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit eolik, vlerësohet se duhet marrë në konsideratë faktin që projekte të tilla, të cilat janë risi për vendin tonë, përballen me vështirësi administrative e financiare. Megjithatë, pavarësisht mosrealizimit në praktikë të projektit, shoqëria ka informuar në vazhdimësi ERE-n për përpjekjet nga e saj për të siguruar investitorët për zbatimin e projektit.

- Shoqëria pretendon se për bankat e angazhuara në këtë investim ka qenë kusht zgjatja e kohës së testimit të nivelit të shpejtësisë së erës dhe të qëndrueshmërisë së saj, e po ashtu që testimi të kryhet nga kompani të licencuara dhe të njohura prej tyre në këtë fushë. Sipas shoqërisë, ky kusht është realizuar nga ana e saj, pasi matjet dhe testimet janë kryer nga shoqëria “Tecnogaia” SRL, e cila është e njohur nga bankat e mësipërme dhe ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me to. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se ka lidhur një marrëveshje me shoqërinë holandeze BS-Green Energy dhe i ka vënë në dispozicion të gjitha të dhënat nga matjet e realizuara nga shoqëria italiane “Tecnogaia” SRL, por shoqëria holandeze mendon se këto matje duhet të ribëhen e se për këtë kërkon të ketë në dispozicion një kohë të mjaftueshme.

Pavarësisht sa deklarohet nga shoqëria, nuk rezulton që ky dokumentacion të jetë vendosur bashkëlidhur. Gjithsesi, ky informacion është administruar edhe më herët në ERE (edhe pse nuk është përcjellë marrëveshje me shoqërinë “Tecnogaia” SRL apo shoqërinë BS-Green Energy, por vetëm aplikimi për regjistrim fillestar dhe rezervimi i emrit të kësaj të fundit në Qendrën Kombëtare të Biznesit) dhe pavarësisht se shoqëria

ka realizuar disa matje në territorin ku është parashikuar të zbatohet projekti, nuk është kryer ende studimi i fizibilitetit, i cili është një nga kushtet thelbësore të vendimit të licencimit nr. 84/2008, i ndryshuar. Vlerësohet se ky dokument duhet të depozitohet në ERE brenda 3 muajsh, për arsye se përgatitja e një dokumenti varet nga vetë shoqëria.

Gjithashtu, pavarësisht se shoqëria ka depozituar më herët në ERE shkresën për shprehjen e interesit që i ka dërguar shoqëria “Alpiq AG” lidhur me shitblerjen e energjisë, kjo nuk përbën një marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët ku të jenë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

- Shoqëria pretendon se i është drejtuar METE-s me shkresën nr. 531, datë 19.1.2012, për t’u pajisur me leje zhvillimore për ndërtimin e impiantit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 531/1, datë 24.4.2012, për plotësimin e procedurës. Më tej, shoqëria deklaroi se është në vazhdim të kësaj procedure dhe duke qenë se ka përfunduar procedura e blerjes së tokës ku do të vendosen turbinat dhe se janë në pritje të avancimit të kësaj procedure nga ana e AZHT-së, për t’u pajisur me leje zhvillimore.

Për sa pretendohet nga shoqëria, nuk ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës të cituar e, po ashtu, nuk është bërë as përditësimi i këtij informacioni për të kuptuar se në cilën fazë ndodhet shoqëria për pajisjen me lejen zhvillimore apo me procedurën për blerjen e tokës, edhe pse depozitimi i saj në ERE nuk është kusht specifik i vendimit të licencimit, por është depozituar në kuadër të përpjekjeve të shoqërisë për të realizuar e vënë në zbatim projektin eolik.

- Shoqëria ka pasqyruar të dhënat që ka marrë nga matja e erës në Lukovë, në Livadhja dhe Markat, të cilat janë regjistruar, përpunuar dhe formatuar nga shoqëria “Tecnogaia” SRL, si dhe ka paraqitur në mënyrë tabelare shpenzimet e bëra deri më tani nga shoqëria për zërat, të tillë si përmirësim rrugësh ekzistuese dhe hapje rrugësh të reja, shpenzime personeli dhe për zyra, shpenzime për taksa lokale, hartim i studimit të rrugëve, vendosje anemometrash etj.

Për gjithë sa më sipër, të dhënat nga matja e erës shoqëria mund t’i përdorë për të realizuar dhe studimin e fizibilitetit, duke përcaktuar dhe të dhëna të tjera, siç vendoset në kushtin pikën 1, germa “a”, të vendimit të Bordit nr. 84/2008, të



ndryshuar, të cilin nuk ka përcjellë ende në ERE. Po ashtu, sa u përket të dhënave mbi shpenzimet e kryera nga shoqëria, ato mbeten në nivelet e deklaratave për sa kohë nuk janë shoqëruar me dokumentacion vërtetues ligjor, si pasqyra financiare të audituara, fatura tatimore, vërtetim për shlyerjen e këtyre të fundit etj.

- Shoqëria është e vetëdijshme se nga ana e saj nuk janë plotësuar disa kushte, sepse asnjë hallkë e shoqërisë nuk ka ecur në mënyrë perfekte e jo më të ecë ky investim që ka siklete e shpenzime tepër të mëdha. Shoqëria kërkon nga ERE që të mos kërkojë perfeksion vetëm nga ajo, sepse ka bërë njoftimet përkatëse në kohë dhe brenda fatit ligjor.

Për sa më sipër pretendohet, shprehur nga shoqëria, përveç vetëdijes që nuk ka plotësuar kushtet e vendimit të licencimit nr. 84/2008, të ndryshuar, sqarojmë se paraqitja nga ana e shoqërisë, brenda afatit të përcaktuar e kërkesave apo dokumentacionit përkatës, është detyrim ligjor i përcaktuar qartë dhe nuk kërkohet në kuadër perfeksioni apo në bazë dallimesh të caktuara.

- Në lidhje me qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e cila është shprehur kundër shtyrjes së afatit për plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit, shoqëria thekson se ERE është organ vendimmarrës me vendim parlamenti, organ kushtetues, dhe i merr vendimet në mënyrë të pavarur nga qëndrimi i ministrisë. Shoqëria pretendon se është pa sens që MIE njofton për shprehje interesi për rritjen e kapaciteteve të reja gjeneruese e në të njëjtën kohë shprehet që të mos vazhdojnë licencat aktuale. Po ashtu, shoqëria shprehet se të gjitha korrespondencat i ka me ERE-n, dhe ka qenë korrekte me të gjitha pagesat e kërkuara nga ERE, që për shoqërinë janë shumë të larta. Më tej, shoqëria ka rikujtuar se nga korrespondenca që ka pasur ERE me ministrinë përkatëse, në lidhje me shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimit, ministria është shprehur dakord nëpërmjet shkresës së saj nr. 7856/1 prot., datë 12.3.2012, në vijim të së cilës ERE ka pranuar kërkesat për shtyrje dhe ata shoqëria ka vazhduar punën për plotësimin e dokumentacionit.

Për sa pretendohet më sipër nga shoqëria, sqarojmë se Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me

ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

Për sa më sipër përcaktuar, ERE i është drejtuar gjithmonë ministrisë në lidhje me qëndrimin e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimeve për ndërtimin e parqeve eolike, ndodhur në rrethanat kur këto shoqëri ende nuk kishin realizuar projektin prej vitesh e po ashtu për arsye se kjo ministri ka në fushën e përgjegjësisë së saj zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve energjetike, në zbatim të VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017. Po ashtu, në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre. Duke qenë se bashkëpunimi me MIE-n për këto çështje është kërkesë e ligjit, ERE për këtë qëllim ka vijuar edhe me dërgimin për mendim në MIE sa herë këto çështje kane qenë objekt rivlerësimi, sipas afateve të përcaktuara në vendimet respektive. Në takimin *online* të datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe ERE-s, MIE ritheksoi mosdakordësinë e saj për shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, mosdakordësi të cilën e kishte shprehur dhe më herët, duke theksuar se është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe VKM-ve të dala në zbatim të këtyre akteve. Në çdo rast këto shoqëri mund të merrnin pjesë në ankandin e organizuar nga MIE për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese e më tej do të vijonin me hapat përkatës për licencimin nga ERE për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, ndaj Bordi i ERE-s u bazua dhe te ky qëndrim në marrjen e vendimit nr. 32/2021.

Në vijim të depozitimit të kërkesës së shoqërisë për rishikimin e vendimit nr. 32/2021, çka tregon vullnetin e shoqërisë për të vijuar me realizimin e projektit eolik, është vlerësuar rishqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të depozituar nga shoqëria në



tërësi, për të vlerësuar nëse plotësohen kushtet për të zgjatur edhe një herë të fundit afatin për plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit nr. 84/2008, të ndryshuar, duke marrë në konsideratë dhe përpjekjet e bëra ndër vite dhe së fundi, nga ana e shoqërisë për plotësimin e këtyre kushteve.

Gjithashtu, për sa i përket pretendimit se shoqëria i ka pasur të gjitha korrespondencat me ERE-n, se edhe shpenzimet i ka relatuar në ERE, sqarojmë se me këtë ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kushtet e licencës përkatëse me të cilën është pajisur, dhe pagesa rregullatore për shoqërinë është caktuar në shuma fikse, në zbatim të përcaktimeve të rregullores përkatëse, e cila është e njëjtë për të gjithë të licencuarit që nuk e ushtrojnë aktivitetin e licencuar, ndaj pretendimi i shoqërisë se pagesa e rregullimit është shumë e lartë për të, nuk qëndron.

- Shoqëria pretendon se nuk është e saktë që një pjesë e turbinave, rreth 15% kalojnë në zona historike dhe në zona të mbrojtura, pasi ajo ka marrë lejen mjedisore për impiantin dhe nuk e ka asnjë problem të tillë. Në lidhje me këtë, shoqëria ka depozituar në ERE dhe shkresën e saj, protokolluar në ERE me nr. 16/3 prot., datë 22.2.2021, në kuadër të saktësimit nga ana e saj të pozicionit gjeografik të impianteve Markat, Livadhja dhe Lukovë, kundrejt zonave historike dhe zonave të mbrojtura. Shoqëria ka depozituar bashkëlidhur pozicionimet në hartë të vendeve ku parashikohen të ndërtohen impiantet eolike, që sipas saj, janë bërë në konsultim me Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga ASIG-u, dhe pretendon se të tri zonat e pozicionimit të impianteve janë shumë larg zonave të mbrojtura, siç shprehet ERE në vendimin e saj.

Në lidhje me këtë pretendim të shoqërisë, sqarojmë se ky nuk është konstatim i ERE-s, por rezultat i studimit të kryer nga ana e konsulencës së angazhuar nga MIE, me fonde të BERZH-it, mbi zonat potenciale për ndërtimin e parqeve eolike, në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga ana e BERZH-i për strategjinë e ndërtimit të parqeve eolike. Në këtë studim ka rezultuar se për subjektin “E-Vento SRL Albania” sh.p.k – një pjesë e mirë e turbinave kalojnë në zona historike dhe rreth 15% e sipërfaqes ku do të ndërtohen turbinat bie në zona të mbrojtura. Për sa më sipër, është përcjellë në kuadrin e rezultatit të studimit të

kryer dhe klasifikimi apo përcaktimi i zonave të mbrojtura nuk është në kompetencën e ERE-s.

- Shoqëria pretendon se ka realizuar shpenzime të jashtëzakonshme dhe minimumi është pranimi i kërkesës së saj për rishikimin e vendimit të Bordit nr. 32/2021, që duhet vlerësuar me kujdes nga ana e ERE-s, pasi çdo vit janë realizuar pagesa e është investuar kohë për realizmin e këtij projekti madhor.

Në lidhje me këtë pretendim të shoqërisë, sqarohet fillimisht se ERE ka marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme dhe ka miratuar disa herë kërkesat e shoqërisë për shtyrje të afatit të plotësimit të kushteve, duke mbajtur parasysh dhe vështirësitë me të cilat ndeshet realizimi dhe zbatimi i projekteve të tilla. Për sa u përket shpenzimeve të kryera nga shoqëria, ato janë në kuadër të realizimit të projektit përkatës nga vetë shoqëria, e cila është përgjegjëse për gjetjen e mjeteve financiare dhe realizimin e pagesave përkatëse. Gjithsesi, shpenzimet e kryera nga ana e shoqërisë janë kryesisht në kuadrin e deklaratave nga ana e saj dhe nuk është depozituar në ERE dokumentacion vërtetues ligjor, si pasqyra financiare të audituara, fatura tatimore, vërtetim për shlyerjen e këtyre të fundit etj.

- Shoqëria pretendon se nëse vendimmarrja e ERE-s është e pakthyeshme, kjo e fundit duhet të gjejë një mekanizëm për të kthyer shpenzimet e realizuara nga ana e shoqërisë, të cilat janë të deklaruara dhe të pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë, të dorëzuara në QKB dhe se ky lloj biznesi kërkon përkrahje nga shteti, pasi si investim është me interes të lartë shtetëror.

Bazuar në pasqyrat financiare të shkarkuara nga faqja elektronike e Qendrës Kombëtare të Biznesit, nga viti financiar 2009 deri në vitin financiar 2019, nuk rezulton që subjekti të ketë kryer investimet siç deklaruar nga ana e tij.

- Me shkresën nr. 501 prot., datë 31.3.2021, ERE i kërkoi shoqërisë që dokumentacionin e përcjellë me *email*-in e datës 15.3.2021, ta depozitonte sipas formës ligjore të kërkuar dhe të përkthyer në shqip, në mënyrë që të bëhet shqyrtimi e vlerësimi i tij. Shoqëria nuk ka kthyer përgjigje për sa kërkuar.

- Për gjithë sa më sipër, pavarësisht se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë ende kushtet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 84/2008, të ndryshuar, me gjithë shtyrjet ndër vite, në lidhje me dokumentacionin për plotësimin e kushteve



respektive të vendimit, subjekti vazhdimisht ka depozituar në ERE informacion për përpjekjet e tij për realizimin/finalizimin e projektit.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

- Duke marrë në konsideratë faktin se nga periudha e licencimit ka kaluar një kohë e gjatë e projekti nuk është vënë në zbatim, e mund të kenë ndryshuar dhe kushtet mjedisore, rikujtojmë se për qëllime të licencimit shoqëria ka deklaruar se është pajisur me autorizimet lokale, dhe ka bërë aplikimin për t’u pajisur me lejen mjedisore. Në këto rrethana, në kuadër dhe të vlerësimit të përpjekjeve të saj për realizimin e projektit, vlerësohet që t’i lihet kusht që të depozitojë, brenda 3 muajsh në ERE lejen mjedisore.

- Po ashtu, brenda 3 muajsh, sipas përcaktimeve të pikës 1, germa “a”, të vendimit nr. 84/2008, të ndryshuar, shoqëria duhet të depozitojë në ERE brenda 3 muajsh, edhe studimin e fizibilitetit, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit, duke përcaktuar në këtë studim koston e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqëruar dhe me grafikun e rishikuar të punimeve.

- Pas depozitimit të lejes së mjedisit dhe studimit të fizibilitetit, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 84/2008, të ndryshuar, konkretisht sipas pikës 1, germa “b”, që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. dhe sipas pikës 1, germa “d”, që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021.

3. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, germa “a”, e vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, ndryshon dhe bëhet:

Ishte:

“a) Kryerjen e një studimi fizibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i koston së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.”

Bëhet:

“a) Shoqëria “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi, studimin e fizibilitetit, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit, duke përcaktuar në këtë studim koston së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqëruar dhe me grafikun e rishikuar të punimeve.”

2. Në pikën 1, të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, pas germës “e”, shtohet germa “f”, me këtë përmbajtje:

“f) Shoqëria “E-Vento SRL Albania” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, lejen mjedisore, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi.”

4. Shoqëria “E-Vento SRL Albania” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi:

a) dokumentacionin ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik;

b) dokumentacionin pronësor për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

5. Me dorëzimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, ERE do të shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 1,



germa “b”, dhe pikën 1, germa “d”, të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.

6. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 112, datë 26.4.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA”
SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
NR. 34, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E
SHOQËRISË ‘HERA’ SHPK, PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT
NR. 61, DATË 2.11.2007,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 58/5 prot., datë 23.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 75, datë 19.3.2021, vendosi:

“1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k., brenda 10 ditëve pune, të dokumentojë në ERE sa pretenduar në shkresën nr. 300/1 prot., datë 17.2.2021.”.

- Ky vendim i Bordit u mor me qëllim që t’i jepej mundësia shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës, për sa pretenduar nga ajo, në kuadër të kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 34/2021. Shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit me shkresën e ERE-s nr. 495 prot., datë 31.3.2021.

- Në përmbushje të afatit të vendosur në vendimin e sipërcituar, u vlerësua rishqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria, në kuadër të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2021, me anë të të cilit filloi procedura për heqjen e licencës së shoqërisë, e po ashtu në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

- Për sa i përket pretendimit të shoqërisë se ajo mban kontrata ligjërish të vlefshme me autoritetet përkatëse, për përdorimin e tokës për të gjithë zonën e shtrirjes së projektit, për një periudhë 30-vjeçare, çka lidhet dhe me kushtin e vendosur në paragrafin e parë të pikës 1, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, e që ka të bëjë me sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave të huapërdorjes ose qiramarrjes, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit, ashtu sikurse parashtuar edhe në informacionet/relacionet e mëparshme për këtë shoqëri, subjekti ka depozituar kontratat respektive të qirasë, të nënshkruara me bashkitë përkatëse pas licencimit nga ERE, në vitin 2009. Nga shqyrtimi i dispozitave të të tria kontratave rezulton se është sanksionuar se rinovimi i tyre duhet të bëhet çdo vit.

Sa më sipër, ky kusht i vendimit të licencimit mund të konsiderohet pjesërisht i plotësuar, pasi shoqëria ka realizuar kalimin nga premtim shitjeje në nënshkrimin e kontratave të qiramarrjes, por në zbatim të kushteve të këtyre kontratave, shoqëria “HERA” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme, për realizimin e projektit. Vlerësohet se për



depozitimin e këtij dokumentacioni shoqërisë t'i lihet një afat prej 3 muajsh.

- Për sa i përket pretendimit të shoqërisë se ka hartuar dhe paraqitur një studim fizibiliteti, i cili plotëson të gjitha kërkesat që duhet të përmbajë një dokument i tillë, çka lidhet dhe me kushtin e vendosur në paragrafin e dytë, të pikës 1, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, që ka të bëjë me kryerjen e një studimi fizibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE përpara fillimit të punimeve dhe për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve, ashtu si parashtruar dhe në relacionet e mëparshme, shoqëria ka përcjellë më herët në ERE studimin e fizibilitetit, ku është përcaktuar mënyra e përlogaritjes së kostos së prodhimit të energjisë elektrike dhe grafiku i rishikuar i punimeve, si dhe instalimi i kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit, që siç teknikisht shpjeguar, bëhet fjalë për instalimin e pajisjeve për matjen e shpejtësisë së erës. Sa më sipër, shoqëria ka përmbushur kushtin e paragrafit të dytë, të pikës 1, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, ndaj ky kusht duhet shfuqizuar.

- Për sa i përket pretendimit të shoqërisë se ka një marrëveshje të vlefshme me OST-në, çka lidhet dhe me kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, ku përcaktohet se shoqëria “Hera” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit, shoqëria ka dokumentuar dhe më parë në ERE shkresën e OST sh.a. nr. 857/1 prot., datë 20.7.2007, për miratimin e pikës së lidhjes së parkut eolik “KAPPET”.

Sa më sipër, ky kusht mund të konsiderohet i plotësuar pjesërisht nga ana e saj, pasi në kuptim të kësaj pike të vendimit kërkohet specifikisht që shoqëria të paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit, çka në fakt përbën dhe vullnetin e

vendimmarrjes përkatëse për licencimin e subjektit në vitin respektiv.

- Në kuadër të përpjekjeve të saj për përmbushjen e kushteve të vendimit nr. 61/2021 dhe zbatimin e realizimin e projektit eolik, shoqëria ka sjellë në vëmendje të ERE-s, se me vendimin nr. 1 të KRRTRSH-së, datë 6.7.2010, është aprovuar me vlefshmëri të përhershme “Detyra e projektimit për masterplanin e zhvillimit dhe rregulloren urbanistike, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale ‘Hera’ sh.p.k.”. Për sa pretenduar nga shoqëria, në lidhje me këtë dokument, që është depozituar edhe më herët në ERE, vlen të theksohet se në pikën 2, të këtij vendimi përcaktohet se në fazën e miratimit të studimit, materiali të pajiset me miratimin nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me shkresën nr. 107 prot., datë 23.8.2013, drejtuar shoqërisë “Hera” sh.p.k., është shprehur në parim dakord, por ka njoftuar shoqërinë se duhet të plotësojë dosjen përkatëse për marrjen e miratimit të plotë, pasi në zonë ndodhen disa monumente kulture. Sa më sipër, është në kuadër të përpjekjeve të shoqërisë për të realizuar projektin eolik, edhe pse ajo nuk ka dokumentuar hapat e mëtejshme, në lidhje me marrjen e miratimeve përfundimtare përkatëse.

- Në lidhje me pretendimin e shoqërisë se ka plotësuar të gjitha kërkesat e tjera që rrjedhin nga vendimi dhe detyrimet e tjera ligjore, përveç sa cituar më sipër, nuk rezulton që shoqëria “Hera” sh.p.k. të ketë përmbushur kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar. Koha e zbatimit e të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj, por ky afat është shtyrë disa herë me vendimet përkatëse të ERE-s ndër vite, për t'i ardhur në ndihmë shoqërisë, duke i krijuar mundësinë për t'u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm që mundëson dhe fillimin e zbatimit të projektit, brenda afateve të shtyra ndër vite nga ERE.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. pretendon se projekti “KAPPET” është një investim privat që nuk ka kërkuar asnjë mbështetje nga organet kompetente dhe në përputhje të plotë dhe në koherencë me politikat e qeverisë Shqiptare, “Planin kombëtar të



veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë në Shqipëri për periudhën 2009–2018”, si dhe “Planin e konsoliduar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë në Shqipëri për periudhën 2019–2020”. Gjithashtu, projekti ka marrë në konsideratë dhe është në përputhje me aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, 2012/04/MCEnC, sipas të cilit për Shqipërinë në veçanti, është konfirmuar objektivi 38% deri në vitin 2020.

Në lidhje me këtë pretendim, konstatojmë se nuk janë realizuar në kohë hapat e implementimit të projektit në veçanti dhe projekti në tërësinë e vet, në mënyrë që të respektohej koherenca dhe përputhshmëria sipas pretendimit të sipërcituar, për t'u realizuar brenda vitit 2020.

- Shoqëria pretendon se ERE, përpara marrjes së vendimit të saj, duhet të kishte konsultuar paraprakisht me përfaqësues të shoqërisë përfundimet e arritura nga monitorimi. Ky pretendim nuk qëndron pasi ERE ka respektuar të drejtën e shoqërisë për të paraqitur objeksionet e saj, në lidhje me gjetjet e monitorimit, të dërguara me shkresën nr. 563 prot., datë 6.3.2020. Në përgjigje, shoqëria, me shkresën nr. 14 prot., datë 10.3.2020, protokolluar në ERE me nr. 563/1 prot., datë 10.3.2020, ka përcjellë sqarimet e saj në vijim të konstatimeve të monitorimit. Sa më sipër, ky pretendim nuk qëndron.

- Shoqëria, duke u nisur nga qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për të mos shtyrë afatet e plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, pretendon se MIE nuk ka asnjë tagër ligjor që t'i japë asaj të drejtë të urdhërojë dhe ndalojë ERE-n të marrë vendime të cilat janë autoritet i saj, siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe për rrjedhojë arsyetimi i ERE-s nuk është i motivuar dhe i vlefshëm ligjërisht.

- Për sa më sipër, ERE i është drejtuar gjithmonë ministrisë, në lidhje me qëndrimin e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimeve, për ndërtimin e parqeve eolike, ndodhur në rrethanat kur këto shoqëri ende nuk kishin realizuar projektin prej vitesh e po ashtu për arsye se kjo ministri ka në fushën e përgjegjësisë së saj zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve energjetike, në zbatim të VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017. Po ashtu, në nenin 10, pika 2, të ligjit nr.

43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji, që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre. Duke qenë se bashkëpunimi me MIE-n për këto çështje është kërkesë e ligjit, ERE, për këtë qëllim, ka vijuar edhe me dërgimin për mendim në MIE sa herë këto çështje kanë qenë objekt rivlerësimi, sipas afateve të përcaktuara në vendimet respektive. Në takimin *online* të datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe ERE-s, MIE ritheksoi mosdakordësinë e saj për shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, mosdakordësi të cilën e kishte shprehur dhe më herët duke theksuar se është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM-të e dala në zbatim të këtyre akteve. Në çdo rast këto shoqëri mund të merrnin pjesë në ankandin e organizuar nga MIE, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese e më tej do të vijonin me hapat përkatës për licencimin nga ERE, për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, ndaj ERE u bazua dhe te ky qëndrim në marrjen e vendimit nr. 34/2021.

- Nga sa analizuar, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në paragrafin e parë, të pikës 1, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, dhe mbeten ende pa u depozituar kontratat e qirasë të rinovuara me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit (paragrafi i dytë i pikës 1), marrëveshja e nënshkruar me OST-në (pika 2), si dhe fakti që shoqëria nuk ka arritur të realizojë projektin brenda afateve të shtyra nga ERE (pika 3).

- Pavarësisht se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë të gjitha kushtet e vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, më gjithë shtyrjet ndër vite, ajo ka dokumentuar në vazhdimësi përpjekjet e saj për plotësimin e tyre, duke treguar dhe një herë vullnetin e saj për të realizuar e zbatuar në praktikë projektin eolik.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e



energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë:

a. të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

- Duke marrë në konsideratë faktin se nga periudha e licencimit ka kaluar një kohë e gjatë e projekti nuk është vënë në zbatim, e mund të kenë ndryshuar dhe kushtet mjedisore, rikujtojmë se, për qëllime të licencimit, shoqëria ka depozituar lejen e mjedisit, kategoria “B” për projektin e parkut “KAPPET”, lëshuar më 13.6.2013, shoqëruar dhe me aktin e miratimit, me nr. identifikimi 1250, datë 11.6.2013. Por gjithashtu, në kushtet e lejes, është përcaktuar se mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe 2-vjeçare sjell për pasojë pavlefshmërinë e lejes për ushtrimin e këtij aktiviteti. Në këto kushte, vlerësohet e arsyeshme që shoqërisë t’i lihet kusht depozitimi i lejes së mjedisit, të rinovuar brenda një afati 3-mujor.

- Pas depozitimit të lejes së mjedisit të rinovuar dhe depozitimit të kontratave të qirasë, të rinovuara me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar, konkretisht sipas pikës 2, që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. dhe sipas pikës 3, që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2021.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2021.

3. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

“1.Paragrafi i parë i pikës 1, të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, ndryshon dhe bëhet, si vijon:

Ishte:

1. Brenda një afati kohor 9-mujor të realizojë:

- Sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull

pronësie dhe realizimin e kontratave të huapërdorjes ose qiramarrjes, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

Bëhet:

- Shoqëria “Hera” sh.p.k të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi, kontratat e rinovuara të qirasë, me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

2. Paragrafi i dytë i pikës 1, të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, shfuqizohet.

3. Pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

5. Shoqëria “Hera” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi, lejen mjedisore të rinovuar.”.

4. Shoqëria “Hera” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi:

a. dokumentacion mbi marrjen e miratimit të plotë nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve;

b. dokumentacion ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik.

5. Me dorëzimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të pikës 3 dhe 4, të këtij vendimi, ERE do të shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit të plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 dhe pikën 3, të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar.

6. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Hera” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 113, datë 26.4.2021****MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
TË PRODHUAR NGA BURIMET E
VOGLA TË RINOVUESHME NGA
DIELLI, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 23.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”,

konstatoi se:

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”.

- Paraprakisht kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1249, datë 7.12.2020, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) informacion në lidhje me autorizimet paraprake

apo miratimet përfundimtare që janë dhënë nga kjo e fundit, gjatë vitit 2020, në lidhje me ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era, si dhe për gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale.

- MIE, me anë të shkresës nr. 1249/1 prot., datë 29.12.2020, është shprehur se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, nuk ka lëshuar asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli, për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, për vitin 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM

Nr. 114, datë 26.4.2021

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
TË PRODHUAR NGA BURIMET E
VOGLA TË RINOVUESHME, NGA
GJENERATORËT E VEGJËL ME BURIM
TË RINOVUESHËM, NGA PJESA E
BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË
NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË
MBETURINA INDUSTRIALE, URBANE
DHE RURALE, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 26.4.2021 të përkatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”,

konstatoi se:

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të

rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”.

- Përpara kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1249 prot., datë 7.12.2020, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) informacion në lidhje me autorizimet paraprake apo miratimet përfundimtare që janë dhënë nga kjo e fundit, gjatë vitit 2020, në lidhje me ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, si dhe për gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale.

- MIE, me anë të shkresës nr. 1249/1 prot., datë 29.12.2020, është shprehur se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, nuk ka lëshuar asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 115, datë 26.4.2021

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA
TË RINOVUESHME NGA ERA,
PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli dhe era”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, të ndryshuar me VKM-në nr. 64, datë 3.2.2021, dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 23.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”,

konstatoi se:

- Në zbatim të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së

energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”.

- ERE, me shkresën nr. 52, datë 13.1.2021, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Autoritetin e Konkurrencës, “Green Tech” sh.p.k., “Anemoi Energy” sh.p.k., si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë, lidhur me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.

- Pranë ERE-s janë paraqitur kërkesat për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3 mw, nga ana e shoqërive “Anemoi Energy” sh.p.k. dhe “Green Tech” sh.p.k., të cilat janë të vetmet subjekte të cilat kanë marrë miratimin përfundimtar nga MIE për vitin 2020.

- Në Shqipëri nuk ka ende të dhëna mbi koston reale të investimit, lidhur me teknologjinë e prodhimit të energjisë nga era (eolike).

- Në vijim të procesit të nisur për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, me fuqi të instaluar deri në 3 mw, për vitin 2020, ERE, me shkresat nr. 272 prot., dhe nr. 273 prot., datë 1.2.2021, duke bërë me dije MIE-n, i ka kërkuar shoqërive “Anemoi Energy” sh.p.k. dhe “Green Tech” sh.p.k. vënien në dispozicion të studimit të fizibilitetit për ndërtimin e centraleve eolike, me fuqi të instaluar 3 mw, si dhe planet e bizneseve të shoqërive të cilat pasqyrojnë kostot për ndërtimin e secilit impiant, të dhëna këto të domosdoshme për analizën e kostove të këtyre impianteve për një



vendimmarrje sa më të drejtë nga ana e ERE-s, në përmbyllje të procesit të nisur me vendimin e Bordit nr. 271, datë 28.12.2020.

- Shoqëritë “Green Tech” sh.p.k. dhe “Anemoi Energy” sh.p.k., me shkresat nr. 272/1 prot., datë 26.2.2021 dhe nr. 273/1 prot., datë 26.2.2021, depozituan në ERE dokumentacionin e kërkuar në përgjigje të kërkesave respektive.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga shoqëritë mbajtëse të miratimit përfundimtar, vlerësohet se kostot e investimit të parashikuara, lidhur me ndërtimin e centraleve eolike dhe efektet e këtyre kostove, mund të jenë të ndryshme nga planet e biznesit gjatë fazës së zbatimit të projektit.

- Miratimi nga ERE i çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, i jep investitorëve sigurinë e nevojshme, lidhur me financimin dhe zbatimin e këtyre projekteve në afat.

- Kostot e parashikuara për ndërtimin e centraleve prodhuese eolike prej 3 mw, nga këto shoqëri, nisur nga vlerësimet në planet e biznesit dhe analizës ekonomike në fazën e projektit, vlerësohen si kosto të arsyeshme dhe kostot më të ulëta nga referencat në dispozicion për vlerësimin e parametrave tekniko-ekonomik, të cilët shërbejnë për përllogaritjen e çmimit të mesatarizuar për teknologjitë eolike, për vitin 2020, të VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, të ndryshuar me VKM-në nr. 64, datë 3.2.2021, si dhe studimit më të fundit të IRENA-s “Renewable Power Generation Costs in 2019”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, i cili ka parashikuar ndër të tjera dhe parametrat tekniko-ekonomike të përdorur për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, është lënë në fuqi dhe për vitin 2021 me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 3.2.2021.

- Për përcaktimin e çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi deri në 3 mw, për vitin 2020, lidhur me koston e

investimit dhe komponentët e LCOE-së në tërësi, janë marrë në konsideratë të dhënat tekniko-ekonomike që rezultojnë nga planet e biznesit të projekt zbatimeve të paraqitura nga 2 shoqëritë, të cilat janë mbajtëse të miratimeve përfundimtare, për ndërtimin e impianteve eolike me fuqi të instaluar deri në 3 mw, si dhe vlerësimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019, të ndryshuar.

- Nisur nga eksperiencia e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2 mw dhe eolike deri në 3 mw, në periudhat e mëparshme, në zbatim të “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, rezulton se çmimi i mesatarizuar për impiantet eolike deri në 3 mw, për vitin 2020, të jetë ai prej 75.64 euro/mwh.

- Në kontratat respektive midis palëve (2 shoqëritë dhe MIE), e më konkretisht nenit 8, pika 2 dhe nenit 10, pika 3 (kontrata e MIE-s me shoqërinë “Green Tech” sh.p.k.), dhe neni 10, pika 4 (kontrata e MIE-s me shoqërinë “Anemoi Energy” sh.p.k.), vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik, si dhe MIE-s, bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimit e veprës, lëshon certifikatën e pranimit të veprës e cila do të përmbajë të dhëna reale tekniko-ekonomike të centraleve prodhuese, në mbështetje të udhëzimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5, datë 13.10.2020, “Për miratimin e procedurave për lëshimin, transferimin, modifikimin ose anulimin e certifikatës së pranimit të veprës për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, nga impiantet që përdorin energjinë nga burime të rinovueshme”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet



eolike, me kapacitet të instaluar deri në 3 mw, prej 75.64 euro/mwh, për vitin 2020.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 25/5, datë 26.5.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Çorovodë”.

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, QYTETI I ÇOROVODËS”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-it)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT Ë PASURISË			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “truall”				
					Pas.			Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
1	Selam	Teki	Koprencka	1420	55/59	Truall	4,000	675	1,015	685,125	685,125	Konfirmuar nga ASHK-ja, DV Skrapar
2	Hektor	Teki	Koprencka	1420	55/61	Truall	4,000	1025	1,015	1,040,375	1,040,375	Konfirmuar nga ASHK-ja, DV Skrapar
3	Mysel Gentjana Devon Ema	Virgjil Vangjel	Koprenckë Hoxha Hoxha Hoxha	1420	55/4	Truall	6,200	300	1,015	304,500	304,500	Konfirmuar nga ASHK-ja, DV Skrapar
Vlera totale paraprake											2,030,000	

Shënim:

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Skrapar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Skrapar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 2,030,000 (dy milionë e tridhjetë mijë) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETARI I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë